

E ëmbël edhe kur të tjerët janë të hidhur

“Shko, shko! Shko rri me bletët...”

Kjo është një nga fjalitë që Xhoana e ka dëgjuar shpesh në vitet e gjimnazit... Në shumë raste miqtë e saj kane bërë shaka për pasionin e saj, por ajo nuk është tërhequr asnjëherë. Bletët ishin bota e saj, që e shoqëronte ndërsa rritej bashkë me endrrat e saj për të ardhmen.

“Ato flisnin për internetin, pamjen e jashtme, kujdesin për veten, ndërsa unë nga pasioni për bletët doja t’u tregoja se sa të mrekullueshme janë ato. Ndihesha gjithmonë e veçuar dhe nuk kam pasur kurrë shumë shoqëri, sepse vajzat më largonin duke më thënë: “Ti një vetëm bletët,” - thotë 18-vjeçarja.

Përkushtimi i saj i madh ndaj bletëve në shumë raste ka bërë që bashkëmohatarët e saj ta shohin ndryshe, madje të kenë paragjykime ndaj saj... Por, me gjithë fjalët e hidhura që dëgjoji bletarja e re, ajo nuk u tërhoq, përkundrazi, u bë edhe më e fortë. Ajo thotë se krahasuar me të gjithë gjimnazistët e fshatit të saj, kur erdhi momenti për të plotësuar formularin e aplikimit për universitet, ndryshe nga shumë bashkëmohatarë që ishin në dilemë dhe jo të mirëinformuar për rrugën e tyre, Xhoana kishte një vizion.

“Isha tejet e qartë për të ardhmen time. Zgjedha të studioj për Inxhinieri Mjedisë në Tiranë. Bëra këtë zgjedhje sepse bletët kanë nevojë për pastërti, një mjedis të pastër dhe prandaj më pëlqen kjo degë”- shprehet ajo.

E ardhmja e ëmbël...

Tani kanë kaluar disa vite nga momenti i parë që ajo u mahnit me bletët kur ishte ende një vajzë e vogël.

E rritur në një familje të varfër, ku të ardhurat vinin vetëm nga mbledhja e luleve dhe shitja e frutave të thata, ajo vendosi si synim të mësonte më shumë për bletët. Kështu, ajo u bë pjesë e trajnimeve të ofruara nga World Vision dhe Shoqata e Bletarëve, si pjesë e projektit të Lehtësimit të Biznesit, në mënyrë që ajo dhe familja e saj t’ia dilnin mbanë.

“Kam kuptuar që bletët janë një burim të ardhurash për familjen time. Në të kaluarën e përdornim mjaltin vetëm për familjen, por tani kam mësuar t’a menaxhoj si biznes. Unë

llogaris gjithçka dhe babai më ka besuar mua. Mbaj të gjitha llogaritë dhe gjithçka që na nevojitet për bletët. Tani me mbështetjen e World Vision kemi edhe 5 koshere të tjera dhe falë trajnimeve kam shumë më tepër njohuri dhe më shumë mjete bashkëkohore për mbledhjen e mjaltit”, - thotë e reja, ndërsa është edhe iniciatore e një grupi bletarësh të rinj në fshatin e saj.

“Nuk ka rëndësi se ku do të shkoj për të mësuar më shumë; do të kthehem gjithmonë tek bletët, në fshatin tim...” – janë fjalët e një 18-vjeçareje që të ardhmen e saj nuk e sheh as në qytet, as në kryeqytet apo në emigracion, por në fshatin e saj të lindjes ku gëlon gumëzhima e bletëve që ben zemrën e saj te rrahë fort.

Gjatë 20 viteve të fundit, World Vision ka trajnuar



2,535 fermerë

për përmirësimin e bizneseve të vogla familjare.

* * *



PIKË GRUMBULLIMI!

NJË ALTERNATIVË E QËNDRUESHME ZHVILLIMI PËR TË RINJTË DHE KOMUNITETET NË LIBRAZHD.





ÇFARË DUHET TË DINI PËR DROGAT?

Informacion për të rinjtë

Drogat janë substanca (kimikate) që ndryshojnë mënyrën se si funksionon trupi i një individi. Ju ndoshta keni dëgjuar se droga është e keqe për ju, por çfarë do të thotë kjo?

Zakonisht kur njerëzit flasin për një "problem me drogën", ata zakonisht nënkuptojnë abuzimin me droga të ligjshme ose përdorimin e drogave të paligjshme, të tilla si ekstazi, kokaina, LSD, meta kristal apo heroina.

Drogat e paligjshme nuk janë të mira për askënd, por ato kanë veçanërisht pasoja tek fëmijët ose adoleshentët, trupi i të cilëve është ende në rritje. Përdorimi i tyre ka ndikim të madh në shëndetin dhe mirëqënien e të rinjve. **Drogat e paligjshme mund të dëmtojnë trurin, zemrën dhe organe të tjera të rëndësishme.**

Individët që përdorin drogë kanë vështirësi më të mëdha në procesin e të mësuarit dhe përqendrimit. Drogat ndikojnë negativisht në qartësinë e mendimit dhe vendimmarrje. Nën ndikimin e drogës mund të ndërmerren veprime të rrezikshme që mund të lëndojnë ata që i përdorin apo të tjerët përreth.

Të rinjtë shtyhen drejt përdorimit të drogës nga arsye të ndryshme: për t'u ndjerë pjesë e një grupi, për kuriozitet, për t'u argëtuar, për të ndryshuar mënyrën se si ndihen sepse duan të ndihen më mirë. Drogat krijojnë varësi. Kjo do të thotë se trupi i personit mësohet aq shumë me këtë substancë, sa që ai nuk mund të funksionojë mirë pa të.



Cilat janë shenjat kryesore që tregojnë se kush përdor drogë?

- Humb interesin për shkollën
- Ndryshon shokët (për të dalë me shokë që konsumojnë drogë)
- Ka luhatje të gjendjes shpirtërore, duket i shqetësuar, i paqëndrueshëm
- Kërkon ta lini vetëm shumicën e kohës
- Ka vështirësi për t'u përqendruar
- Fle shumë (madje edhe në klasë)
- Përfshihet në zënka dhe sherre
- Ka sy të fryrë e të skuqur
- Shton në peshë ose bie nga pesha
- Ka shumë kollë
- Hundët i rrjedhin shumicën e kohës



Si mund të ndihmoni?

Nëse mendoni se dikush që ju njihni po përdor drogë, gjëja më e mirë për të bërë është t'i tregoni një të rrituri tek i cili keni besim. Ky mund të jetë prind, i afërm tjetër, mësues, apo psikolog shkolle. Personi që konsumon drogë mund të ketë nevojë për ndihmë profesionale për të ndaluar përdorimin e drogës. Një i rritur mund ta ndihmojë personin përdorues të drogës të gjejë trajtimin e nevojshëm për të ndaluar përdorimin e saj.

Përgatitur nga: **Florian Kulla, Psikolog.**

“Pikë Grumbullimi! Një alternativë e qëndrueshme zhvillimi për të rinjtë dhe komunitetet në Librazhd” është projekti që do të zbatohet përgjatë 28 muajve në zonën e Librazhdit.

Projekti do të jetë një alternativë dhe nxitje për të rinjtë në zonë duke iu dhënë mundësi të përfitojnë nga modelet pozitive të njëri-tjetrit. Më anë të këtij projekti synojmë gjithashtu eliminimin dhe parandalimin e kultivimit të drogave të paligjshme nëpërmjet masave të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik rural që përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të jetës.

Të rinjtë e përfshirë në këtë projekt do të jenë nga moshë 12-25 vjeç.

Ata do të ftohen të eksplorojnë mundësitë që ofron zona si dhe do nxiten të fillojnë që në këtë moshë të gjenerojnë ide se si të mund t'i shfrytëzojnë më tej këto mundësi.



HISTORI SUKSESI:

E ardhmja e ëmbël e xhoanës

“Nuk i kuptoj miqtë e miqë e shohin të ardhmen jo në Shqipëri, por në emigracion. E di që do t'ia dal në vendin tim dhe do të bëhem një inxhinieri e suksesshme. E di se çfarëdo pune që të bëj, sado që do të fitoj çdo muaj, pasioni për bletët do të jetë gjithmonë pjesë e jetës sime dhe e së ardhmes sime,” – tregon me pasion Xhoana.

Ajo është vetëm 18 vjeç dhe sapo ka nisur rrugëtimin drejt së ardhmes, një rrugë që e sheh qartë, pa dilema, ashtu siç do të ishte e zakonshme për bashkëmoshatarët e saj.

“Ëndrra ime është të menaxhoj një park të madh bletësh, këtu në fshatin tim, në Librazhd,” - na tregon 18-vjeçarja.



E rritur mes bletëve

Xhoana është rritur mes bletësh, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, kjo ka qenë përditshmëria e saj.

Kurioziteti dhe dëshira për të eksploruar, njohur natyrën dhe atë që e rrethon, e kanë shoqëruar gjithmonë, që kur ishte e vogël. Takimi i saj me botën e ëmbël të bletëve erdhi krejt rastësisht për të, kur fqinji i saj u largua nga fshati dhe la pas një bletë që kishte ikur nga kosherja.

“Disa vite më parë, një fqinj u largua dhe la një bletë që kishte lënë kosheren e saj në një pemë aty pranë. Ai i tha babait tim që nëse donte, mund të kujdesej për të. Isha shumë kurioze dhe që në momentin e parë e ndoqa babain tim teksa shkonte te bletët çdo herë. Kështu, mësova çdo ditë e më shumë. Kujdesi për bletët është diçka që më tërheq pa masë; është pasioni im më i madh. Kur punoj me bletët, harroj pjesën tjetër të botës...” – tregon Xhoana.